

VENDIM
Nr. 75, datë 22.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	
Sokol Berberi	anëtar i	“	“	
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	
Gani Dizdari	anëtar i	“	“	
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“	
Fatos Lulo	anëtar i	“	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.6.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 34 Akti, që i përket:

KËRKUES: Tom Doshi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 39, datë 26.3.2015 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe nr. 15, datë 28.3.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 15, 27, 28, 30, 32, 42/1/2, 43, 49/1, 131/f, 134/1/g dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 2.3.2015, kërkuari Tom Doshi, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), është shprehur publikisht se ka pasur një tentativë për vrasje ndaj tij dhe një deputeti tjetër në verën e vitit 2014.

2. Në datën 3.3.2015 nga ana e Prokurorisë për Krimet e Rënda është filluar kryesisht procedimi penal nr. 63 për veprën penale të vrasjes së funksionarëve publikë, mbetur në tentativë, e parashikuar nga neni 79/a, në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit D.B. *(i cili është ndaluar me urdhër të prokurorit dhe më pas arrestuar, me masë sigurimi “arrest me burg”)*.

3. Në datat 11.3.2015 dhe 17.3.2015 kërkuari ka kërkuar me shkrim dhënien e shpjegimeve nga Prokurori i Përgjithshëm për fakte për të cilat kërkuari e kishte vënë në dijeni, përfshirjen në hetimin e çështjes të prokurorëve dhe ekspertëve ndërkombëtarë, si dhe administrimin si prova të filmimeve të aeroportit të Hanoverit, Gjermani. Me vendimin e datës 19.3.2015, Prokuroria për Krimet e Rënda ka vendosur mospranimin e këtyre kërkesave.

4. Në datën 20.3.2015 Prokuroria për Krimet e Rënda ka shpallur moskompetencën e saj dhe ia ka dërguar çështjen Prokurorit të Përgjithshëm, i cili po në këtë datë ka regjistruar procedimin penal nr. 1 për veprat penale të kallëzimit të rremë, kanosje për deklarament a dëshmi, ekspertim ose përkthime të rreme dhe deklaratatë të rreme përpara prokurorit (*parashikuar respektivisht në nenet 305, 305/a dhe 312/a të Kodit Penal*), në ngarkim të kërkuesit, deputetit M.F. dhe shtetasit D.B.

5. Me shkresën nr. 1004/2 prot., datë 20.3.2015, Prokurori i Përgjithshëm ka depozituar në Kuvend kërkesën për dhënie autorizimi për arrestimin ose heqjen e lirisë, si dhe për të ushtruar kontrollin personal dhe të banesës së deputetit Tom Doshi.

6. Në datat 21.3.2015, 23.3.2015 dhe 25.3.2015, kërkesa e Prokurorit të Përgjithshëm u shqyrtua nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në datën 25.3.2015 ky këshill konkludoi me raportin përkatës, i cili u vendos në rendin e ditës së seancës plenare të datës 26.3.2015.

7. Me vendimin nr. 39, datë 26.3.2015, Kuvendi vendosi dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë së deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zotit Tom Doshi, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm me kërkesën nr. 1004/2 prot., datë 20.3.2015.

8. Me urdhrin “Për ndalimin e të dyshuarit për një krim”, datë 26.3.2015, Prokurori i Përgjithshëm urdhëroi ndalimin e kërkuesit dhe zbatimin e këtij urdhri nga Policia Gjyqësore e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

9. Në datën 27.3.2015 Prokuroria e Përgjithshme depozitoi në Gjykatën e Lartë kërkesën për “Vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit të shtetasit Tom Doshi dhe caktimin për të si masë sigurimi atë të arrestit me burg”.

10. Me vendimin nr. 15, datë 28.3.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi *inter alia*: “Vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit të shtetasit Tom Doshi. Caktimin si masë sigurimi atë të arrestit në shtëpi, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale (...). Në zbatim të pikave 2 dhe 3 të nenit 237 të KPP-së, kufizimin e shtetasit Tom Doshi për të komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me të”.

II

11. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë vendimmarrjes së Kuvendit dhe Gjykatës së Lartë. Më konkretisht, pretendimet përqendrohen në këto aspekte:

11.1 *Shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë procedimit nga Prokuroria e Përgjithshme për arsyet e mëposhtme:*

11.1.1 Në kushtet kur akuza e bërë publike nga kërkuesi, për tentativë vrasje ndaj tij, drejtohej ndaj një deputeti (*Kryetarit të Kuvendit*), kompetente për regjistrimin e procedimit penal dhe zhvillimin e hetimeve duhej të ishte Prokuroria e Përgjithshme dhe jo Prokuroria Për Krime të Rënda.

11.1.2 Prokurori i Përgjithshëm ka vepruar (*regjistrimi i çështjes penale, nxjerrja e urdhrit të ndalimit etj.*), duke qenë në konflikt interesi, pasi ai ka qenë i përfshirë në këtë ngjarje.

11.1.3 Urdhri i ndalimit i Prokurorit të Përgjithshëm është marrë në tejkalim të kompetencave të deleguara me vendimin nr. 39, datë 26.3.2015 të Kuvendit, ku thuhet se vlerësimin në rast se janë ose jo kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase sigurimi personal [...] e bën sistemi gjyqësor, nëpërmjet organit të tij, gjykatës, bazuar në parashikimet e posaçme të KPP-së. Sipas kërkuesit, autorizimi i Kuvendit është dhënë në përputhje me nenin 73/2 të Kushtetutës dhe nuk lejon që Prokurori i Përgjithshëm të veprojë me iniciativë ndaj deputetit duke urdhëruar ndalimin e tij.

11.2 *Shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë procedurave të dhënies së autorizimit nga Kuvendi për arsyet e mëposhtme:*

11.2.1 Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, edhe pse u vu në dijeni të faktit se kërkesa e prokurorisë kishte prapavijë politike, pra kishte arsye të rëndësishme për të dyshuar *humus*

persecutionis, u shpreh në favor të dhënies së autorizimit.

11.2.2 Kërkesa kaloi për votim në kundërshtim me nenin 73, pika 4, të Kushtetutës, e cila urdhëron që votimi të bëhet i hapur. Në votimin e Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm morën pjesë edhe deputetë të cilët kishin konflikt interesi, për faktin se ishin të përfshirë në hetimin dhe procedimin penal që kishte zhvilluar Prokuroria për Krimet e Rënda.

11.2.3 Mungesa e arsytimit të vendimit të Kuvendit nr. 39 dhe mungesa e kërkuarit që të mund të realizonte mbrojtjen e tij edhe para Kuvendit në seancë plenare cenon procesin e rregullt ligjor.

11.3 Shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë vendimmarrjes në Gjykatën e Lartë për arsyet e mëposhtme:

11.3.1 GJL-ja nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës së paraqitur nga mbrojtja, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 28, pika 4, të Kushtetutës dhe parimin e rëndësishëm që gjykata duhet të shprehet për gjithçka që i kërkohet.

11.3.2 Njëkohësisht në këtë gjykim është cenuar edhe parimi i paanshmërisë, pasi në shqyrtimin e saj ka marrë pjesë gjyqtarja M.A., e cila kishte paraqitur kërkesë për dorëheqje nga gjykimi i çështjes për shkak të konfliktit të interesit.

11.3.3 Vendimi i GJL-së, edhe pse *de jure* shprehet për një masë shtrënguese, *de facto* ka vendosur edhe një masë ndaluese për kërkuar, duke e privuar atë nga e drejta për të ushtruar veprimtarinë e tij si deputet, gjë që bie ndesh me nenin 242/2 të KPP-së, ku parashikohet, ndër të tjera, se masa për pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral.

11.4 Është shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë nga Prokuroria e Përgjithshme, pasi të gjitha veprimet e organit procedues deri në caktimin e masës së sigurimit personal nga GJL-ja dëshmojnë haptazi se procedimi penal në ngarkim të kërkuarit është paragjykuar. Prokuroria në këtë mënyrë ka influencuar edhe në procedurat parlamentare, si dhe në vendimmarrjen e GJL-së, duke nxitur dhe krijuar presion mbi këto organe, që nga ana e tyre kanë shkelur normat kushtetuese dhe ligjore.

11.5 Gjatë procedurave të dhënies së autorizimit nga Kuvendi shkelja e parimit të prezumimit të pafajësisë evidentohet në faktin se edhe pse votimi në Kuvend është një votim politik, përpara shqyrtimit të kërkesës në këshill, ishin shprehur publikisht Kryeministri, Kryetari i Kuvendit, ministri i Brendshëm dhe një numër deputetësh, të cilët ishin thirrur si deklarues nga Prokuroria gjatë hetimeve të akuzës për vrasje të mbetur në tentativë.

11.6 Në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, shkelja e parimit të prezumimit të pafajësisë bazohet në faktin se GJL-ja nuk ka mbajtur një qëndrim objektiv dhe të paanshëm në vlerësimin e kërkesës së prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit personal për sa kohë është bazuar në një sërë deklaramesh të disa prej funksionarëve të lartë të shtetit. Gjithashtu, duke e mbështetur vlerësimin në akte të cilat janë të lidhura me një procedim tjetër (nr. 63/2015 për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë), GJL-ja ka vlerësuar vetëm mbi një bindje të paraformuar nga publiciteti i çështjes.

11.7 Është cenuar e drejta themelore e lirisë dhe sigurisë personale, për shkak se kërkuari është ndaluar në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin.

11.8 Është cenuar e drejta për të mos inkriminuar vetveten dhe për të mos dëshmuar kundër vetvetes (neni 32 i Kushtetutës), pasi në bazë të kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Kuvendit janë vendosur disa deklaramë që kërkuari ka dhënë në funksion të procedimit penal nr. 63/2015.

11.9 Është cenuar e drejta për t'u njohur me akuzën, pasi si në procesin e zhvilluar në Kuvend, ashtu edhe në GJL, jo vetëm atij nuk i është krijuar mundësia të njihet me aktet e dosjes, por nuk i është komunikuar as formalisht akuza, duke cenuar në këtë mënyrë edhe mbrojtjen efektive.

12. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar:

12.1 Në lidhje me pretendimin e kërkuarit për shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë procedimit nga Prokuroria e Përgjithshme

12.1.1 Procedimi penal për veprën penale të vrasjes së funksionarëve publikë, mbetur në tentativë, është regjistruar kryesisht nga ana e prokurorisë dhe jo mbi bazën e ndonjë kallëzimi penal.

Në bazë të nenit 75/a të KPP-së, kompetencën lëndore për këtë vepr penale e ka vetëm Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Për më tepër, nga ana e kërkuesit nuk është bërë asnjë kallëzim penal në ngarkim të Kryetarit të Kuvendit.

12.1.2 Të gjitha veprimet procedurale dhe hetimore të kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda janë të bazuara në ligjin penal dhe procedural penal. Hetimet e kësaj çështjeje kanë përfunduar dhe është marrë vendim për dërgimin e saj për gjykim pranë Gjykatës së Lartë, e cila është edhe gjykata kompetente për shqyrtimin e çdo kërkesë paraprake ose për pavlefshmëri të akteve procedurale, përfshirë edhe ato të hetimit paraprak.

12.1.3 Referuar nenit 131 të Kushtetutës, rezulton se nuk është në juridiksionin e GJK-së pajtueshmëria ose vlefshmëria e akteve procedurale dhe hetimore me ligjin penal dhe procedural penal.

12.1.4 Argumenti se Prokurori i Përgjithshëm ka vepruar duke qenë në konflikt interesi është i pabazuar në ligj dhe në faktet e procedimit penal, pasi nga ana e kërkuesit as nuk është përmendur dhe as nuk është arsyetuar se cilat pikat konkrete të neneve 16 dhe 17/1 të ligjit procedural penal janë cenuar nga veprimet e kryera nga Prokurori i Përgjithshëm.

12.1.5 Kërkesa për dhënien e autorizimit për arrestimin e kërkuesit është paraqitur para Kuvendit në përputhje me nenin 73/2 të Kushtetutës, si dhe nenin 288 të KPP-së. Si rrjedhim, kërkesa drejtuar Kuvendit për dhënie autorizimi nuk ka asnjë lidhje me faktin se cilën procedurë ligjore do të zbatojë Prokuroria e Përgjithshme për arrestimin apo heqjen e lirisë. Kjo procedurë është në diskrecion të organit të prokurorisë në varësi të rrethanave të faktit penal, rrezikshmërisë shoqërore të faktit dhe personit për të cilin kërkohet arresti ose heqja e lirisë.

12.1.6 Nxjerrja e urdhrat të ndalimit për kërkuesin nuk nënkupton se ndaj tij prokuroria ka caktuar një masë sigurimi, por që për caktimin e masës i është drejtuar gjykatës kompetente, e cila, duke vlerësuar kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase sigurimi, ka dhënë vendimin nr. 15, datë 28.3.2015.

12.2 *Pretendimi i kërkuesit se gjatë procedurave të ndjekura nga organi i prokurorisë, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë është cenuar e drejta e kërkuesit për të mos inkriminuar vetveten dhe mos dëshmuar kundër vetes, garantuar nga neni 32 i Kushtetutës, është i pabazuar dhe për më tepër nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.*

12.3 *Për pretendimin se me vendimin nr. 15 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i është cenuar e drejta kushtetuese për të ushtruar profesionin e tij si politikan dhe deputet*

12.3.1 Pretendimi është i pabazuar, sepse vet ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë rastet dhe kriteret për caktimin e një mase sigurimi personal shtrënguese dhe një masë sigurimi ndaluese. Një masë me karakter shtrëngues vendoset vetëm mbi bazën e vlerësimit të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara qartë në nenet 228, 229 dhe 230 të KPP-së, të cilat janë të ndryshme nga ato mbi të cilat vlerësohet caktimi i një mase sigurimi me karakter ndalues. Sipas nenit 242/2 të KPP-së, ligjvënësi ka sanksionuar ndalimin e zbatimit të një mase ndaluese ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, por ky sanksionim nuk mund të interpretohet me analogji dhe as nuk mund të mbahet në konsideratë në rastin e caktimit të një mase sigurimi personal me karakter shtrëngues.

13. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), në parashtrimet drejtuar Gjykatës, vlerëson se kërkesa është e pabazuar dhe duhet rrëzuar për këto arsye:

13.1 Në shqyrtimin e kërkesës për dhënie autorizimi për arrestimin, heqjen e lirisë, kontrollin personal dhe kontrollin e banesës së deputetëve, Kuvendi ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor bazuar në nenin 73/2/4 të Kushtetutës, nenin 288 të KPP-së dhe nenet 13 dhe 118 të Rregullores së Kuvendit.

13.2 Në relacionin e Prokurorit të Përgjithshëm drejtuar Kuvendit, ishte pasqyruar kryerja e një sërë veprimesh procedurale të parashikuara nga KPP-ja, siç janë: pyetja e personave që kanë dijeni mbi ngjarjen, këqyrja e provave materiale të administruara nga organi hetimor, përgjime ambientale,

ballafaqimi mes subjekteve të procedimit etj.

13.3 Kërkesa dhe relacioni i paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm i janë njoftuar deputetit dhe janë marrë në shqyrtim nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

13.4 Refuzimi i kërkesave të paraqitura nga deputeti Tom Doshi gjatë procedurës parlamentare në lidhje me administrimin e provave specifike, është konsultuar me përfaqësuesit e organit të prokurorisë, të cilët kanë mbajtur qëndrimin se të gjitha veprimet hetimore, të kryera në kuadër të këtij procedimi penal, përbëjnë sekret hetimor dhe në vështirësi të nenit 103 të KPP-së ndalohet publikimi i tyre.

13.5 Pretendimi se votimi i fshehtë i ka cenuar atij të drejtën për një proces të rregullt ligjor nuk është ngritur në nivel kushtetues, për sa kohë kërkuesi nuk ka parashtruar në kërkesë asnjë argument se në cilin aspekt dhe komponent të saj, ky aspekt procedural e ka cenuar këtë të drejtë themelore.

13.6 Kuvendi ka respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë gjatë kryerjes së procedurave për dhënien e autorizimit. Kuvendi ka analizuar relacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm dhe ka konstatuar bazueshmërinë në argumente për dhënie autorizimi. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të kërkesës nga Kuvendi, kërkuesi i janë garantuar të gjitha të drejtat për një mbrojtje efektive. Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit nuk mund të njoftonte akuza dhe as nuk mund ta njihte kërkuenin me aktet e dosjes hetimore, pasi këto veprime janë procedurale dhe i përkasin prokurorisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

14. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individ mund t'i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shtetur të gjitha mjetet juridike. Shtetimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 27, datë 20.6.2007, nr. 28, datë 23.6.2011 dhe nr. 53, datë 22.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Shtetimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkueti, i cili, para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009, nr. 1, datë 25.1.2010, nr. 17, datë 16.5.2011 dhe nr. 60, datë 21.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*)

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin e duhur në zbatimin e saj. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkojë vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Dhunimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimit dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte. Duke qenë se kërkueti i ka shtetur mjetet e ankimit për “masën e arrestit në burg” dhe ankohet ndaj një vendimi të Gjykatës së Lartë, karakteri i këtij vendimi të ndërmjetëm e kërkon, si përjashtim, që ai të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (*shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*)

16. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se masa e sigurimit personal është caktuar nga Gjykata e Lartë në ushtrim të juridiksionit të saj fillestar dhe për rrjedhojë, kërkueti nuk ka në dispozicion asnjë mjet tjetër ankimi ndaj këtij vendimi. Në këto kushte, bazuar në standardet e interpretuara në vendimin e referuar më sipër (*vendimi nr. 28, datë 23.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vlerëson se

ky vendim do të konsiderohet përfundimtar, për rrjedhojë kërkuesi e ka përmbushur kushtin legjitimues të shterimit të mjeteve të ankimit.¹

17. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se ka juridiksion edhe mbi akte juridike me natyrë individuale, siç janë vendimet e Kuvendit apo dekretet e Presidentit të Republikës, vetëm në rastet e ankesave të funksionarëve publikë për mbrojtjen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*shkronja "J" e nenit 131 të Kushtetutës*) (*shih vendimin nr. 76, datë 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese*). Shqyrtimi i këtyre akteve nga Gjykata nuk është kryer në kuptim të kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike, por si rrjedhojë e kompetencave të tjera që burojnë nga neni 131 i Kushtetutës.

18. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se në rastin konkret kërkuesi nuk disponon mjet tjetër ankimi edhe në lidhje me vendimin e Kuvendit, për rrjedhojë ai legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në kuptim të ankimit individual për procesin e rregullt ligjor.²

19. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit *prima facie* lidhen me aspekte të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ndaj në vijim merr në analizë këto pretendime:

B. Për pretendimin për shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë procedimit nga Prokuroria e Përgjithshme

20. Kërkuesi ka pretenduar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk ka pasur kompetencë lëndore për regjistrimin dhe zhvillimin e hetimeve në kushtet kur akuza e bërë publike nga kërkuesi, për tentativë vrasje ndaj tij, drejtohej ndaj një deputeti. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se urdhri i ndalimit është marrë nga Prokurori i Përgjithshëm në kushtet e konfliktit të interesit dhe në kapërcim të kompetencave të deleguara nga Kuvendi me vendimin nr. 39, datë 26.3.2015.

21. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për procedurën e ndjekur nga Prokuroria e Përgjithshme lidhen ngushtësisht me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave procedurale penale lidhur me çështje të kompetencës lëndore, vlefshmërinë e akteve procedurale, vlerësimin e bazueshmërisë së shkaqeve për të urdhëruar ndalimin e personit që dyshohet për një krim etj.

22. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit material, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, në çështjen konkrete rezulton se aspektet e ligjshmërisë së urdhrit të ndalimit dhe aspektet procedurale lidhur me të i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, për rrjedhojë Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar në lidhje me pavlefshmërinë.

C. Për pretendimin për shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë vendimmarrjes në Gjykatën e Lartë

23. Sipas kërkuesit, GJL-ja nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha kërkesave të paraqitura nga mbrojtja, si dhe ka cenuar parimin e paanshmërisë, pasi në gjykim ka marrë pjesë gjyqtarja M. A., e cila kishte paraqitur kërkesë për dorëheqje nga gjykimi i çështjes për shkak të konfliktit të interesit. Gjithashtu, edhe pse GJL-ja *de jure* shprehet për një masë shtrënguese, *de facto* ka vendosur edhe një masë ndaluese për kërkuesin, duke e privuar atë nga e drejta për të ushtruar veprimtarinë e tij si deputet, gjë që bie ndesh me nenin 242/2 të KPP-së.

24. Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me respektimin e parimeve bazë të shtetit të së drejtës, në të cilat parimi i ligjshmërisë zë një vend të rëndësishëm. Gjykata është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë

¹ Gjyqtaret V.Tusha dhe A.Xhoxhaj kanë votuar kundër me argumentin se vendimi i GJL-së nuk është përfundimtar, për rrjedhojë Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e pretendimeve lidhur me këtë vendim.

² Gjyqtari B. Imeraj ka votuar kundër legjitimitimit me arsyetimin se vendimi i Kuvendit është një akt individual.

kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 29, datë 9.11.2005; nr. 19, datë 3.5.2007; nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka ushtruar kompetencat e saj për vleftësimin e ligjshmërisë së urdhrit të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin në përputhje me ligjin procedural penal dhe parimet e një procesi të rregullt ligjor. Konkretisht, rezulton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim në seancë vleftësimin e masës së ndalimit brenda afateve procedurale (*seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 28.3.2015, ndërkohë që kërkesa e Prokurorisë së Përgjithshme është paraqitur në datën 27.3.2015*) me pjesëmarrjen e prokurorit dhe mbrojtësve të caktuar nga kërkuesi. Gjithashtu, Kolegji Penal ka vleftësuar si të ligjshëm ndalimin e kërkuesit dhe ka vendosur masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, pasi ka dëgjuar pretendimet e palëve duke u bazuar në aktet e paraqitura në gjykim.

25. Për më tepër, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit nuk janë ngritur në nivel kushtetues për sa kohë çështjet e pretenduara prej tij, si: disponimi i gjykatës mbi kërkimet e mbrojtjes, disponimi mbi pranimin e heqjes dorë nga gjyqtari, si dhe vlerësimi i kriterëve dhe kushteve për vendosjen e masës së sigurimit personal, lidhen ngushtësisht me zbatimin e normave procedurale penale. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Sa më sipër, Gjykata çmon se nuk është kompetente të shqyrtojë pretendime në lidhje me interpretimin e ligjit, për rrjedhojë pretendimet e ngritura nga kërkuesi dalin jashtë juridiksionit të saj.

Ç. Për pretendimin për shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë procedurave të dhënies së autorizimit nga Kuvendi³

26. Gjykata vëren se argumentet e kërkuesit lidhur me këtë pretendim përqendrohen kryesisht në procesin e votimit, duke u ndalur veçanërisht në pamundësinë e kërkuesit që të mund të realizonte mbrojtjen para Kuvendit, për shkak të mungesës së tij në seancë plenare, pjesëmarrjen në votim të deputetëve, të cilët kishin konflikt interesi, si dhe në shkeljen e nenit 73, pika 4, të Kushtetutës, dispozitë e cila urdhëron që votimi të bëhet i hapur.

27. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar një sërë elementesh, mungesa e të cilave e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Kështu, argumentimi i shkeljeve që i atribuohen personit, respektimi gjatë shqyrtimit të çështjes i parimit të ndarjes së pushteteve, njohja paraprake e personit ndaj të cilit kërkohet të merret masa me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cenimin e së cilës, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast si shkelje të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 76, datë 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesit i janë argumentuar shkeljet që i atribuohen, çka del e qartë nga dokumentet e Kuvendit bashkëlidhur kërkesës (*raporti i Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet*), ku thuhet se kërkesa dhe relacioni i paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 118/1, prot, datë 20.3.2015 i është njoftuar deputetit Doshi (*kërkuesi*), [...], gjithashtu, nëpërmjet kësaj shkrese kërkuesit i është njoftuar ora dhe data e zhvillimit të mbledhjes. Për më tepër, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet ka shtyrë edhe disa mbledhje me kërkesë të kërkuesit për t'i dhënë këtij të fundit mundësinë për të ushtruar mbrojtjen e tij me avokat, si dhe për të realizuar prezencën e tij gjatë mbledhjes së këtij Këshilli. Siç rezulton nga seanca e datës 25.3.2015 dhe në vijim, kërkuesi ka realizuar një debat të plotë e kontradiktor lidhur

³ Lidhur me këtë pretendim, gjyqtari S.Berberi është me mendimin e shumicës, por me arsyetim tjetër.

me argumentet e prokurorisë, çka tregon se gjatë këtij procesi nga ana e Kuvendit janë respektuar standardet e mësipërme.

29. Lidhur me pretendimin për mënyrën e votimit në seancën plenare për dhënien e autorizimit, Gjykata konstaton se Kuvendi nuk ka respektuar nenin 73 të Kushtetutës, i cili parashikon se: “[...] 2. *Deputeti nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo formë apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.* [...] 4. ***Për çështjet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur***”. Në kundërshtim me këtë dispozitë votimi për kërkuesin është bërë në mënyrë të fshehtë.

30. Megjithatë, Gjykata, duke shqyrtuar në tërësi procesin e zhvilluar në Kuvend arrin në përfundimin se kjo shkelje që nuk duhet të përsëritet në të ardhmen, nuk e bën atë të parregullt në kuptimin kushtetues, përderisa Kuvendi ka bërë të gjitha përpjekjet për të garantuar të drejtën e kërkuesit për t’u dëgjuar dhe mbrojtur.

31. Për sa më sipër u parashtrua, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë procedurave të dhënies së autorizimit nga Kuvendi është i pabazuar.

D. Për pretendimet e tjera

32. Kërkuesi ka ngritur edhe pretendime të tjera lidhur me cenimin nga Kuvendi dhe Gjykata e Lartë të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për të mos inkriminuar vetveten etj.

33. Gjykata thekson se në thelbin e një gjykimi të drejtë qëndrojnë të gjitha garancitë për individin, nga respektimi i të cilave arrihet të përfitohet e drejta për të pasur një seancë të drejtë e ligjore. Ndër parimet e një gjykimi të drejtë renditet e drejta e personit të akuzuar për veprën penale për t’u prezumuar i pafajshëm dhe lidhur ngushtë me të edhe e drejta për të mos u detyruar të dëshmosh kundër vetvetes ose të pranosh faj. Parimi i prezumimit të pafajësisë, sipas jurisprudencës kushtetuese, do të thotë që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet të mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte, të cilat duhet të provohen nga akuza” (*shih vendimet nr. 9, datë 28.4.2004 dhe nr. 19, datë 18.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se këto pretendime për nga natyra lidhen kryesisht me garancitë procedurale në një proces gjyqësor. Megjithatë, referuar edhe procedurës së ndjekur nga Kuvendi, nuk rezulton që ky organ të ketë bërë deklaratë në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e deputetit. Gjithashtu, Gjykata vëren se edhe gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë nuk rezultojnë prova që të pasqyrojnë faktin se anëtarët e Kolegjit Penal të kësaj gjykate, që kanë gjykuar çështjen, e kanë paragjykuar çështjen. Për më tepër, në caktimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin, Gjykata e Lartë nuk ka gjykuar themelin e çështjes, për rrjedhojë nuk mund të shprehej për fajësinë e kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

35. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga Kuvendi dhe Gjykata e Lartë është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

MENDIM PARALEL

Në çështjen me kërkesë Tom Doshin, ndonëse ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës, nuk pajtohem me linjën e arsytimit të bërë prej saj në lidhje me pretendimin për shkelje të parimit të ligjshmërisë gjatë procedurave të dhënies së autorizimit nga Kuvendi. Për këtë arsye e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel, për sa i përket juridiksionit të Gjykatës dhe standardeve të kontrollit për këtë pretendim.

Gjykata përpara se të shqyrtonte bazueshmërinë e këtij pretendimi, së pari, duhej të kishte evidentuar të drejtën që, sipas kërkesit, është cenuar nëpërmjet një procesi të parregullt gjatë procedurave për dhënien e autorizimit; së dyti, duhej të vlerësonte nëse kjo e drejtë është cenuar nga vendimmarrja e Kuvendit; së treti, të përcaktonte elementet e procesit të rregullt që duhet të respektohen nga Kuvendi gjatë procedurave vendimmarrëse për heqjen e imunitetit.

Kërkesi, në thelb, pretendon cenimin e lirisë dhe të garancive kushtetuese që lidhen me heqjen e lirisë sipas neneve 27, 28 dhe 42 të Kushtetutës. Por, a është Kuvendi që vendos për kufizimin e lirisë nëpërmjet procedurave vendimmarrëse për heqjen e imunitetit? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje duhet të kemi parasysh dhe të sqarojmë kuptimin dhe qëllimin që kanë imuniteti parlamentar dhe procedurat parlamentare për heqjen e imunitetit.

Bazuar në nenin 73/2 të Kushtetutës deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit. Në vështrim të nenit 73 të Kushtetutës deputetët gëzojnë imunitet parlamentar për sa kohë kanë statusin e deputetit. Garancitë që u jepen deputetëve bëjnë të mundur ushtrimin e funksioneve nga ana e tyre pa pasur frikën e kërcënimit apo akuzave të pabaza nga ekzekutivi, gjykatat apo kundërshtarët politikë (*shih raportin CDL-AD (2014) 011 të Komisionit të Venecias*). Imuniteti parlamentar që gëzojnë deputetët nuk ka si qëllim mbrojtjen e tyre individuale, por garantimin e mirëfunksionimit të Kuvendit si një organ kushtetues. Edhe nga pikëpamja historike arsyeja e vendosjes së parashikimeve ligjore të paprekshmërisë penale është mbrojtja e Parlamentit si institucion nga presioni i papërshtatshëm/i tepruar i degëve të tjera të pushtetit. Imuniteti është një institut i cili i shërben edhe kontrollit dhe balancimit të pushteteve, duke mbrojtur, nga njëra anë, sferën e kompetencave të këtyre pushteteve dhe, nga ana tjetër, duke shmangur ndërhyrjen në këto kompetenca (*shih vendimin nr. 212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

Rregullat e paprekshmërisë parlamentare janë problematike për disa arsye. Së pari, çdo lloj paprekshmërie penale përbën në vetvete një cenim të parimit të barazisë përpara ligjit, si element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës. Së dyti, rregullat mbi paprekshmërinë parlamentare mund të keqpërdoren nga persona të cilët kanë shkelur ligjin dhe kërkojnë të mbrohen nëpërmjet statusit të deputetit. Së treti, këto rregulla mund të kontribuojnë në uljen e besimit të Parlamenti si institucion dhe të politikanët, si pjesë përbërëse e tij. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se këto rregulla janë në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve, përkundrazi ato shihen si pjesë e sistemit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve (*checks and balances*) dhe më specifikisht kanë si qëllim mbrojtjen e Parlamentit nga ndërhyrjet e degëve të tjera të pushtetit (*shih raportin CDL-AD (2014) 011 të Komisionit të Venecias*).

Dhënia e autorizimit nga Kuvendi për kryerjen e disa veprimeve të caktuara procedurale ndaj deputetëve, që gëzojnë paprekshmëri penale, rregullohet nga neni 73/2/4 i Kushtetutës, neni 288 i KPP-së dhe nenet 13 dhe 118 të Rregullores së Kuvendit.

Në vështrim të këtyre dispozitave vërehet se procedura e dhënies së autorizimit është si vijon: kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit i paraqiten Kryetarit të Kuvendit nga Prokurori i Përgjithshëm (neni 118 i Rregullores së Kuvendit); kërkesa për autorizim paraqitet kur ekziston një dyshim i arsyeshëm i mbështetur në prova dhe kur plotësohen kushtet ligjore procedurale për arrestin, heqjen e lirisë në çfarëdolloj forme apo ushtrimin e kontrollit personal ose të banesës së deputetit (neni 288 i KPP-së); kërkesa shoqërohet me një relacion, ku prokurori parashtron provat dhe argumentet ligjore për kërkesën e paraqitur (neni 288 i KPP-së); Kryetari i Kuvendit ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Imunitetin dhe Mandatet dhe vë në dijeni deputetin (neni 118 i Rregullores); deputeti ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij rreth çështjes (neni 118 i Rregullores); në përfundim të shqyrtimit, Këshilli harton një raport që u shpërndahet deputetëve për në seancë plenare, në të cilin rekomandon rrëzimin ose miratimin e dhënies së autorizimit (neni 118 i Rregullores); në seancë plenare fjala i jepet në fillim deputetit, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, për të dhënë shpjegime ose për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Raporti i Këshillit nuk është objekt diskutimi. Kuvendi vendos me votim të fshehtë nëse do të jepet ose do të rrëzohet dhënia e autorizimit (neni 118 i Rregullores).

Në këto raste, kur duhet të japë autorizimin për kryerjen e veprimeve procedurale të përcaktuara në nenin 73/2 të Kushtetutës, Kuvendi bën një vlerësim formal të kërkesës së paraqitur nga prokuroria. Sipas Komisionit të Venecias presupozohet se imuniteti duhet të hiqet në të gjitha rastet kur nuk ka arsye të dyshohet se akuzat ndaj deputetit janë të motivuara politikisht. Parimi mbizotërues është që kërkesat për heqje të imunitetit duhet të pranohen në të gjitha rastet, përveç rasteve kur ka shkak për të dyshuar se ekziston *fumus persecutionis*, pra qëllimi i dikujt për të keqpërdorur sistemin penal për motive politike dhe për të ndjekur penalisht deputetin në mënyrë të padrejtë. Edhe Kuvendi kur shqyrton kërkesat për dhënie autorizimi verifikon pikërisht nëse ka apo jo arsye për të pasur dyshime për ekzistencën e *fumus persecutionis* dhe nuk vlerëson lidhur me fajësinë ose pafajësinë e deputetit apo nëse ndjekja penale është e justifikuar ose jo. Rrjedhimisht, nuk është vendimarrja e Kuvendit që konkludon për kufizimin e lirisë së deputetit.

Komisioni i Venecias, për sa i përket procedurës parlamentare për heqjen e imunitetit, ka mbajtur qëndrimin se është e vështirë për Parlamentin (komisionin parlamentar përkatës) të vlerësojë heqjen e imunitetit pa u futur në detajet dhe themelin e akuzave penale të rastit specifik dhe pa formuar një opinion paraprak. Kjo në praktikë konfliktin me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe mund të perceptohet si një lloj gjykimi politik mbi çështjen e fajësisë. Gjithashtu, kjo është në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, sipas të cilit vetëm gjykatat mund të vlerësojnë përgjegjësinë penale individuale. Këto procedura nuk duhet t'i ngjajnë një procedimi gjyqësor dhe në asnjë rast nuk duhet të vlerësojnë për fajësinë e deputetit, e cila vlerësohet vetëm nga gjykatat. Organi parlamentar që shqyrton kërkesat për heqje imuniteti nuk duhet të bëjë një vlerësim ligjor të çështjes si të tillë (*shih raportin CDL-AD (2014) 011 të Komisionit të Venecias*).

Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se paprekshmëria penale ndihmon për të arritur pavarësinë e plotë të Parlamentit, duke parandaluar çdo mundësi të procedimeve penale të motivuara politikisht (*fumus persecutionis*) dhe mbron pakicën parlamentare nga presioni ose abuzimi i shumicës parlamentare. Mekanizmi për zbatimin e detyrimit parlamentar, që konsiston në marrjen e një vendimi për të hequr apo jo imunitetin, është një nga mënyrat me të cilat Parlamenti ushtron autonominë e tij. Vendimet e marra nga organet parlamentare, të cilat janë organe politike, janë rrjedhimisht, për nga natyra, vendime politike dhe jo vendime gjyqate, kështu që ato nuk mund të pritet që të plotësojnë të njëjtat kritere si vendimet gjyqësore, kur vjen puna për të dhënë arsyet (*shih vendimin Kart kundër Turqisë, datë 3 dhjetor 2009; përkthim i Gjykatës*).

Bazuar në argumentet dhe standardet e mësipërme, çmoj se procedura e dhënies së autorizimit nga Kuvendi, si rregull, nuk mund të vlerësohet nga Gjykata në aspektin e procesit të rregullt. Dhënia e

autorizimit nga Kuvendi nuk sjell automatikisht kufizimin e lirisë për deputetin; është organi i prokurorisë që vendos për masat e sigurimit dhe kufizimin e lirisë, të cilat më pas i nënshtrohen kontrollit gjyqësor. Gjithashtu, ky është një proces të cilit i mungojnë elementet thelbësore të procesit të rregullt ligjor të elaboruara nga Gjykata Kushtetuese. Për më tepër, paprekshmërinë penale deputeti e gëzon për shkak të funksionit të tij si anëtar i Kuvendit dhe pjesë përbërëse e tij dhe jo si individ, titullar i pozicionit që mban.

Nisur nga sa më sipër, çmoj se pretendimi i kërkuarit për shkelje të ligjshmërisë gjatë procedurave për dhënien e autorizimit nga Kuvendi duhej të ishte rrëzuar nga Gjykata për mosargumentim nga ana e kërkuarit, lidhur me të drejtën e cenuar, si dhe për mungesë të juridiksionit kushtetues në këtë çështje.

Anëtar: Sokol Berberi